

Në pajtim me nenin 15 të Ligjit për Planifikim Hapësinor, nr. 2003/14, të zbatueshëm sipas Rregullores së PSSP të KB. nr. 2003/30, nenit 3 (nen b) të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2000/45 për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, nenit 19, alineja 1, pika 2, dhe nenit 39, alineja 7 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit në mbledhjen e vet të mbajtur më 25 maj 2006, mori këtë:

## V E N D I M

Për miratimin e Planit Rregullues Urban për një pjesë të lokacionit "Qendra e Re" të Prizrenit

### Neni 1

Me këtë Vendim bëhet miratimi i PRrU-së për një pjesë të lokacionit "Qendra e Re" të Prizrenit, të hartuar nga NTSH Studio Projektuese "Diarko" nga Prizreni (bartës i hartimit të Planit), hartuar në pajtim me Planin Zhvillimor Urban të Prizrenit.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi për miratimin e PRrU do të jetë elaborati me të gjitha shtojcat grafike dhe tekstuale.

Pjesa tekstuale përmban:

- Kushtet për rregullimin dhe destinimin e ndërtimit në këtë hapësirë.

Pjesa grafike duhet të përmbajë:

- paraqitjen grafike të planit rregullues urban.

### Neni 2

Me Planin Rregullues Urban për një pjesë të "Qendrës së Re" të Prizrenit përfshihen këto ngastra kadastrale: 2752/1; 2752/2; 2752/3; 2752/4; 2748; 2751/1; 2751/2; 2751/3; 2751/4; 2751/5; 2743; 2740; 2733; 2732; 2733; 2742; 2742; 2742; 2742; 2742; 2742; 2742; 2742; 2737; 2737; 2737; 2733/2740; 4782; 8618; 8619; 8620; 8621; 8622; 8623; 8624; 8627; 8626/1; 8625/2; 8625; 8625; 8625; 8625; 8625; 8625; 9625; 8625; 8625; 8625; 8625; 8625; 8625; 8625; 8625; 8625; 8625; 8625; 8625/3; 8625/4; 8625/6; 9014; 9015/1; 9015/2; 9015/3; 9016; 9017; 9018; 9019; 9051; 11041; 1145; 8628/1; 8628/2; 8628/3; 8628/4; 8628/5; 8628/6; 8628/7; 8628/8; 8628/9; 8628/10; 8628/11; 8628/12; 8628/13; 8628/14; 8629 në sipërfaqe prej 17,60 ha, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 39 ha, 14 ari e 7 m<sup>2</sup>, të paraparë me Planin Zhvillimor (të definuar si qendër e madhe administrative, kulturore, afariste – shërbyese, banesore).

### Neni 3

Plani Rregullues Urban – "Qendra e Re", përfshin lokacionin që ndodhet në hyrje të qytetit, respektivisht në jugperëndim të Prizrenit dhe përkufizohet me:

- Lumin Lumëbardhi në juglindje dhe verilindje përgjatë tërë zonës së kontaktit;
- Me kufirin e rrugës "Wiliam Woker" në veriperëndim dhe atë duke u nisur nga ura e "Kaçanikëve" (përballë ndërtesës së SHPK-së);
- Të dy anët e rrugës "Tahir Sinani" duke filluar prej udhëkryqit me rrugën "Wiliam Woker" deri në kufirin e rrugës që e ndan vargun e shtëpive nga tregu i plaçkave dhe me parcelën e Pylltarisë në jugperëndim.

Neni 4

Me Planin nga neni 1 i këtij Vendimi është i planifikuar rregullimi i hapësirës në pajtim me Planin Zhvillimor Urban që bazohet me nevojat reale për zhvillimin e ardhshëm me qëllim që t'ua mundësojë qytetarëve jetën në një qytet me planifikim dhe kushte të sigurta të investimit.

Neni 5

Plani Rregullues Urban do të vlejë për periudhën kohore më së paku 5 (pesë) vjeçare.

Neni 6

Ky Vendim bashkë me dokumentacionin e përshkruar në nenin 1, al. 2 të këtij Vendimi do të jetë pjesë përbërëse e Planit Zhvillimor Urban të Qytetit të Prizrenit.

Neni 7

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike dhe Drejtoria për Gjeodezi e Kadastër.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi që dita e miratimit dhe i njëjti do të shpallet në "Kumtar".


**KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT**

Asambleja Komunale

Nr 01/011-28

Më 25 maj 2006

Prizren



Kryetari i Kuvendit  
Mr. Eqrem Kryeziu